



VENDIM

Nr. 107, Datë 29.06.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË
SHOQËRISË “BALKAN GREEN ENERGY” SH.P.K ME NR.3,
SERIA.PVO3K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TE
KOMISIONEREVE NR. 69, DATË 12.12.2007**

Në mbështetje të neneve 16; 43 pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 930, datë 02.09.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe shoqërisë italiane “Essegei”, s.p.a, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave; nenit 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave miratuar me Vendimin nr. dhe nenit 19 pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve, për modifikimin e liçensës së shoqërisë “Balkan Green Energy”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FAVINA sh.p.k në cilësinë e pronarit të Hec “Voskopojë” i është drejtuar ERE me shkresën nr. 100 Prot., datë 21.01.2016, duke kërkuar rritjen e fuqisë së instaluar të këtij hec-i.
- ERE pas verifikimeve të bëra, konstaton se mbështetur ne vendimin nr. 69, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionereve te ERE, eshte shoqëria koncesionare “Balkan Green Energy” sh.p.k e licencuar per te ushtruar aktivitetin e prodhimit nga HEC-“Voskopoja”.
- ERE me shkresën nr. 101/1 Prot., date 20.04.2016, i është drejtuar MEI-t, në lidhje me saktësimin e pronësisë së Hec “Voskopojë”.
- MEI është përgjigjur me shkresën nr. 2810/1, date 23.05.2016, përmes së cilës i ka kërkuar ERE-s, zbatimin e marreveshjes se konçesionit ne perputhje me VKM Nr.930 datë 02.09.2009.

- VKM Nr. 930 datë 02.09.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në marrëveshjen shtesë të koncesionit për 25 hidrocentralet vendore, të lidhur ndërmjet ministrisë së ekonomisë, tregtisë dhe energjetikës dhe shoqërisë italiane "Essegei", s.p.a, miratuar me vendimin nr.148, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave ka hequr nga lista e HEC-eve për te cilat është licencuar Shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. hec-et: “Piqeras”, “Lozhan” dhe “Voskopojë” në zbatim të nenit 5 i cili përcakton se: “Trajtimi i hidrocentraleve Piqeras, Lozhan dhe Voskopojë, do të merren në dorëzim dhe do të trajtohen nga Organi Shtetëror i Autorizuar.”
- Neni 43 pika 1 e ligjit nr. 43/2015 parashikon se: ERE mund të modifikojë licencën, me iniciativën e vetë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licensës me numër Nr.3, Seria PV03K, dhënë shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k, me Vendim të Bordit të ERE-s Nr.69, dt.12.12.2007, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 930, datë 02.09.2009.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.